



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr. 215/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Nuhi Paçarizi, – Kryetar, z. Blerim Dina- Referues dhe z. Goran Milenković-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Flamuri 1979” – Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Xoni SH.P.K& N.SH. Osmani” Suharekë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Suharekës”, me numër të prokurimit: 624-19-314-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë, më datën 12.06.2019 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Flamuri 1979” – Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Suharekës”, me numër të prokurimit: 624-19-314-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Suharekës”, me numër të prokurimit: 624-19-314-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“Flamuri 1979” – Suharekë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë. 11.02.2019

Lloji i procedurës së aplikuar : Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: Kontratë publike kornizë, Shërbim

Vlera e parashikuar e kontratës: 46,445.00€

Kriteri për dhënie të kontratës: tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.: 05.03.2019

Data e hapjes së ofertave.: 05.03.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave: 26.04.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm: 30.04.2019

Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës: 26.04.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim.: .06.05.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim; 1 07.06.2019

Operatori ekonomik ankues “Flamuri 1979” – Suharekë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me: 16.05.2019 me nr. 215/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Xoni SH.P.K. & N.SH. Osmani” Suharekë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Suharekës”, me numër të prokurimit: 624-19-314-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 Mjetet për promovimin e transparencës; Neni 57 Sigurimi i Tenderit; Neni 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve; Neni 69 Aftësia teknike dhe ose profesionale; Neni 39 RrUOPP-se.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.05.2019 ka autorizuar



ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:31.05.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “Flamuri 1979”, është njoftuar nga AK-Komuna Suharekës si tenderues i pasuksesshëm dhe ne ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontratë.

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues, i cili pretendon se OE i rekomanduar për kontratë duhet të shpallet i papërgjegjshëm me arsyetimin se i njëjtë ne informatorin e certifikatës se biznesit nuk e ka veprimtarin adekuate – 5210, eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, ne dosje te tenderit nuk ka kërkuar qe operatori ekonomik te këtë te regjistruar veprimtarin adekuate te natyrës se këtij aktiviteti te prokurimit. Prandaj ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin tjetër te OE ankues, qe ka te beje me kontratat dhe referencat e OE te rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues pretendon se kontrata me titull: Riparimi i automjeteve te dëmtuara, kontratë e nënshkruar me datën: 28.01.2014, dhe ne nenin 11 te kësaj kontratë thuhet se kontrata lidhet ne kohëzgjatje te pacaktuar. Ndërsa ne referencën e dorëzuar për këtë kontratë thuhet se “Menaxhmenti i kompanisë Sigma për vitin 2016, 2017 dhe 2018 lëshon referencën me titull: Transporti i automjeteve te dëmtuara për riparim”.

Eksperti shqyrtues, sa i përket këtij pretendimi, vlerëson se kjo kontratë ka kundërthënie për fakti se siç u sqarua edhe me lart ne kontratë thuhet: Riparimi i automjeteve te dëmtuara dhe nuk përmendet transporti i automjeteve, ndërsa ne referencë përmendet vetëm transporti i automjeteve. Prandaj ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se nuk është dashur te vlerësohet pa u sqaruar sipas nenit 72 te LPP-se.

Poashtu eksperti vlerëson si te qëndrueshëm pretendimin e OE ankues sa i përket kontratës me titull: Transporti i masës drusore, për faktin nuk ka te beje me natyre e këtij aktiviteti te prokurimit.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar listën e kontratave dhe referencave te OE te rekomanduar për kontratë fillimisht sqaron se ne total i rekomanduari për kontratë ka ofruar listën e kontratave dhe referencave ne vlere prej: 102,146.00 euro.

Përfundimisht eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet e dhëna me lart për dy kontratat dhe vlerën totale te ofruar nga i rekomanduari për kontratë, sqaron se kur zbritet vlere e dy kontratave te lartpërmendura



rezulton se totali është 65,451.00 euro, qe do te thotë vlere është brenda kërkesës se AK-se te kërkuar ne dosje te tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Pretendimi tjetër i OE ankues ne lidhje me kontratat dhe referencat ka te beje atë se sipas OE ankues ka dorëzuar kontrata fiktive me te cilët ka lidhje familjare apo marrëdhënie tjera shoqërore, konkretisht kontrata me operator privat.

Eksperti shqyrtues, sa i përket këtij pretendimi vlerëson se është i paqëndrueshëm për faktin se ne dosje te tenderit nuk është kërkuar qe për kontratat me operator ekonomik privat te dëshmohen me dëshmi tjera shtese dhe njëherit sqaroj se sipas nenit 56.3 te LPP-se nuk mund te eliminohet një operator ekonomik për një kërkesë apo dëshmi e cila nuk është e vendosur paraprakisht ne dosje te tenderit.

Prandaj, eksperti shqyrtues ne fund vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar kërkesën e AK-se, për kontrata dhe referenca, duke u bazuar ne vlerën përfundimtare prej: 65,451.00 euro.

Lidhur me pretendimin e OE ankues për shkelje te nenit 41 te RRUOPP-se, për shkelje te afateve ligjore qe kanë te bëjnë me afatin e vlerësimit te ofertave, eksperti shqyrtues e vlerëson si te paqëndrueshëm për faktin se përveç 50 ditëve qe parashihen ne nenin e lartpërmendur, ne te njëjtin nen parashihen edhe deri ne 5 dite pasa hapjes se ofertave, fillimi i punës se komisionit te vlerësimit.

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues për çmimin e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, për te cilin pretendon se ka ofruar çmim Jo/ Normalisht te ulet. Eksperti shqyrtues vlerëson se sipas paragrafit 3 te nenit 61 te LPP-se, është e drejte e AK-se, qe marrjes se informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë dhe njëherit lidhur me nenin 61 te LPP-se, eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja i ka respektuar procedurat e nenit te lartpërmendur, për çmimin e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë.

#### Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa vendimi për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 03.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.



Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 30.05.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, ekspertit shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Veseli deklaroj: Te nderuar kryesues te nderuar anëtar te panelit pretendimet ankimore i kemi paraqitur ne OSHP ku ne mënyrë te qartë i kemi potencuar te gjitha shkeljet dhe për te cilat kemi argumente dhe prova konkrete se pretendimet tona qëndrojnë . E kundërshtojmë raportin e ekspertizës te ekspertit shqyrtues sepse i njëjti është kundërthënës i pa kuptimet dhe i papërshtueshëm i cili nuk ofron prova konkrete për konstatimet te cilat eksperti i evidenton në raportin e ekspertizës, prandaj ky raport si i tille duhet te hedhetposhtë plotësisht nga paneli i OSHP-se për arsye se do te ishte e dëmshme për vet ekspertin, për vet Autoriteti Kontraktues te merret i arsyeshëm. Dëshiroj ti bashkëngjis i dorëzoj panelit deklaratimet e seancës me shkrim panelit qe te jetë pjese e procesverbalit te kësaj seance ky deklarim përmban 4 faqe te nënshkruara dhe te vulosura.

Arsyet qe duhet te hedhet posh raporti janë: Autoriteti Kontraktues ka shpallur fitues një OE i cili ka ofruar çmimin jo racional me te ulet se çmimi i tregut, çmim i cili nuk mund te ofrohen shërbimet ne DT nga Autoriteti Kontraktues ne sqarimin te cilin e ka bre Autoriteti Kontraktues kërkesën për sqarim OE, dhe OE ka dhen si sqarim një sqarim i cili është i papranueshëm dhe ehte ne kundërshtim me DT dhe me lejoni te shpjegoj se ai e konsideron se është ne njëlargësi 1.7 Km nga Qendra e qytetit kurse shpenzimet e transportit nuk i tejkalon 1.2 euro ndërsa AP e ka titullin “ Shërbimet e zhvendosjes me merimanga dhe bllokimi i automjeteve ne territorin e Komunës se Suharekës” gjithashtu ne pyetjen e kërkuar nga OE Flamuri është kërkuar qe te sqarohet kjo pyetje dhe Autoriteti Kontraktues e ka sqaruar qe shërbimet do te kryhen ne te gjithëterritorin e Komunës se Suharekës” nuk e kuptoj si Autoriteti Kontraktues dhe eksperti ketë e ka marr si te sqaruar dhe a do ti shërbej kjo qëllimit te tenderit.

Përfaqësuesi i kompanisë Flamuri deklaroi: se OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar kontrata fiktive për te cilat nuk ka ofruar asnjë dëshmi për realizimin e tyre te gjitha kontratat i ka me OE privat, nuk ka dorëzuar faturat tatimore te rregullta për shërbimet e kryera, nuk ka ofruar pagese përmesbankës për shërbimet e kryera dhe ne bazë te informacioneve te besueshme qe i posedojmëkëtojanë kontrata fiktive dhe nuk janë te deklaruar ne ATK. Poashtu kontrata ne mes te Anëtarit te Grupit te OE N.SH. “OSMANI” e



lidhur me kompaninë e sigurimeve "SIGMA" ne bazë te nenit 1 te kësaj kontrate palëtkanë rene dakord Për riparimin e automjeteve te cilat dëmtohen nga fatkeqësitë e komunikacionit", për te njëjtën kontrate Grupi i OE-ve "Xoni SHPK & N.T. OSMANI kanë ofruar ne Autoriteti Kontraktues me rastin e aplikimit për këtë tender kanë dorëzuar reference me titull "Transporti i automjeteve te dëmtuara për Riparim" do te thotë kontrata ka qene "riparimi i automjeteve" kurse referencia është paraqitur "transporti i automjeteve për riparim".

Ne këto raste ligji për prokurim publik ne mënyrë taksative parasheh se si duhet te vepohet ne rastet kur OE ofrojnë informacione jo te vërteta- mashtruese. Edhe pse Autoriteti Kontraktues e ka mbajtur ne ekzaminim-vlerësim DT për 51 dite ka bere kinse nuk e ka vërejtur këto informacione jo te vërteta, po ashtu grupi i OE Xoni shpk dhe OSMANI asnjëri prej tyre nuk ka ofruar qarkullimin bankar te kërkuar sipas DT-së dhe njoftimit për kontrate, lidhur me këtë

fakt Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar informacione për qarkullimin bankar. Edhe pse ne te njëjtën procedurë te prokurimit Grupi i OE-ve te TCK SHPK dhe AIM SHPK është shpallur i papërgjegjshëm pikërisht për këtë fakt se nuk e ka ofruar qarkullimin bankar te kërkuar sipas ditës dhe njoftimit për kontrate, ne këtë rast Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne mënyrë te kundërligjshme dhe me standarde te dyfishta.

Duke u bazuar ne sqarimin shtesë te ofruar nga Autoriteti Kontraktues te datës 01.03.2019 ne te cilën theksohet se "Shërbimet e transportit do te kryhen ne tere territorin e Komunës se Suharekës, qe nënkupton edhe Fshatrat e KK-SUHAREK andaj bazuar ne faktin se disa fshatra janë larg nga qendra e qytetit 15, 16 dhe 17 KM si është e mundur te realizohet kontrata me çmim 2.55 euro te ofruar nga OE fitues. Kërkojmë qe te sqarohet ne këtë seance si duhet te vepohet ne rastet ne rastet ku OE ofron Informacione mashtruese. Dhe si ka mundësi qe te merret i bazuar një sqarim si është e mundur te realizohet një kontrate me çmime abnormalisht te ulëta me 2.55 cent ne distance 17 KM.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Kuçi deklaroi: Përgjigje do te jen vetëm ne pretendimet ankimore ne ankesën ne OSHP, Autoriteti Kontraktues ne vendimin e kërkesë për rishqyrtim ka dhen arsyetimet ne pretendimet ankimore duke sqaruar se OE i propozuar për kontrate ka plotësuar kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional konkretisht ka ofruar listën e kontratave dhe referencat siç është kërkuar me FDT. Sa i përket çmimit joabnormalisht te ulet ju informojmë se kjo ka qenë një pike qe Autoriteti Kontraktues i ka shqyrtuar te 2 ofertat edhe te propozuarit për kontrate edhe te OE ankues. Kriteri ka qenë çmimi me i ulet me poentim, janë disa pozicione qe janë vlerësuar sipas përqindjes ( peshës) dhe ne kemi respektuar RrUOPP-në dhe rregulloren për çmimet jo normalisht te ulëta duke ber kërkesë ne form b41 te OE i shpërblyer nga i cili kemi marr përgjigje detale siç është kërkuar po ashtu kemi marr një konfirmim qe i njëjti është i gatshëm te rris përqindjen e sigurimit siç kërkohet me LPP-në ne mënyrë qe shërbimet te kryhen sipas kërkesave te Autoriteti Kontraktues konform specifikimeve teknike. Ne mes te 2 çmimeve njeri



dukshëm mbi vlerën e parashikuar dhe tjetri dukshëm me i ulet se kjo vlere por me një konfirmim se shërbimet do te kryhen sipas specifikimeve teknik e Autoriteti Kontraktues konform kriterit për dhënie me çmim me te ulet ka shpërblyer OE e rekomanduar.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Basha deklaroi: Sa i përket pretendimit te OE ankues ne lidhje me kontrata dhe referencat q i përmendi edhe këtu ne seance kontratën e lidhur ne mes te OE te rekomanduar për kontrate me kompaninë SIGMA dhe me kontratën tjetër te Transporti i Mases drusore te cilat i ka atakuar ne ankese kam vlerësuar se edhe po te hiqen nga lista( zbriten) si vlere prap i nijeti e plotëson kërkesën e Autoriteti Kontraktues me kontrata dhe referenca tjera. Ne lidhje me kontratat dhe referencat OE ankues e ka edhe një pretendim te cilin e theksoj këtu ne seancë qe ka te beje me kontratat me OE privat për te cilat OE ankues pretendo se i njëjti ka mashtruar me kontratat qe i ka me OE privat dhe për te njëjtat nuk ka ofruar as provën me te vogël. Mbes pran raportit te ekspertizës.

Ne pyetjen e Përfaqësuesit të OE ankues drejtuar Ekspertit shqyrtues se marr parasysh qe kontrata me Sigmen ka qenë Riparimi i Automjeteve, kurse referenca për te njëjtën kontrate është ofruar kinse Transporti i automjeteve, bazuar ne faktin qe nëketë rast nuk kemi gabim teknik por ne mënyrë te hapur informacion mashtrues, si duhet te vepohet ne rastet kur OE ofron dëshmi jo te vërteta- mashtruese.

Lidhur me pyetjen e lartcekur përgjigjen e dha Kryetari i Panelit i cili deklaroi : është vepër penale dhe është kompetence e organeve hetuese te cilave mund te ju drejtohesh.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroi: Bazuar nga pretendimet ankimore si dhe deklarimet me goje dhe me shkrim i propozoj panelit shqyrtues te aprovoj ankesën plotësisht te bazuar ankesën e Flamurit, te hedhë poshtë vendimi i Autoriteti Kontraktues dhe te kthej lenden ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroi: Kërkojmë qe te hedh poshtë ankesën e OE dhe te na lejoj te vazhdojmë me AP.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues “Flamuri 1979”, është njoftuar nga AK-Komuna Suharekës si tenderues i pasuksesshëm dhe ne ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontratë.



Lidhur me pretendimin e OE ankues,se OE i rekomanduar për kontratë duhet te shpallet i papërgjegjshëm me arsyetimin se i njëjtë ne informatorin e certifikatës së biznesit nuk e ka veprimtarin adekuate – 5210. Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se AK-ja, në dosje te tenderit nuk ka kërkuar qe operatoret ekonomik te kenë te regjistruar veprimtarin adekuate te natyrës se këtij aktiviteti te prokurimit, pra nuk kanë kërkuar numrin e lartcekur qe ta kenë në certifikatën e biznesit ofertuesit, mirëpo AK ka kërkuar vetëm certifikata te regjistrimit te biznesit, konstatojmë se ky pretendim i ankuesit është i pa bazuar dhe se secili biznes ne Republikën e Kosovës ka te drejte te ushtroj çdo veprimtari te ligjshme, pasi qe kodi nuk ka qene kërkesë ne dosje te tenderit.

Lidhur me pretendimin OE ankues se OE i rekomanduar per kontrate ka dorëzuar kontrata fiktive dhe se kontrata me titull: Riparimi i automjeteve te dëmtuara, kontratë e nënshkruar me datën: 28.01.2014, dhe ne nenin 11 te kësaj kontratë thuhet se kontrata lidhet ne kohëzgjatje te pacaktuar. Ndërsa ne referencën e dorëzuar për këtë kontratë thuhet se “Menaxhmenti i kompanisë Sigma për vitin 2016, 2017 dhe 2018 lëshon referencën me titull: Transporti i automjeteve te dëmtuara për riparim”.

Paneli shqyrtues, konstaton se kontrata e lartcekur është kundërthënëse me Referencën e cekur si me lart për fakti se siç u sqarua edhe me lart ne kontratë thuhet: Riparimi i automjeteve te dëmtuara dhe nuk përmendet transporti i automjeteve, ndërsa në referencë përmendet vetëm transporti i automjeteve po ashtu edhe vitet e cekura si me lart janë kundërthënëse. Prandaj ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se dëshmitë e lartcekura ose nuk do te duhet të merreshin si e vlefshme ose për të njëjtat do te duhej te kërkohej sqarim sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konstaton se është i qëndrueshëm pretendimi i OE ankues sa i përket kontratës me titull: Transporti i masës drusore, për faktin se kontratat në fjalë nuk ka te beje me natyrën e këtij aktiviteti te prokurimit, dhe nuk përkon me kërkesën e AK-së ku është kërkuar që :Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 60.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve dhe si dëshmi për kërkesën në fjale ka specifikuar: Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjashme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, DHE dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbalet e pranimit teknik.

Autoriteti Kontraktues duhet ti vërtetoj këto pretendime, pasi qe, nëse këto pretendime qëndrojnë, atëherë kjo do te thotë se OE i rekomanduar për kontrate ka tentuar qe te nënshkruaj kontrate duke paraqitur deklarate te rrejshme apo duke e mashtruar Autoritetin Kontraktues edhe pse eksperti shqyrtues deklaroi se ka kontrata



te tjera qe e plotësojnë kërkesën e AK-se, Për panelin shqyrtues është e pa pranueshme qe te shpërblehet me kontrate një OE me dokumente te falsifikuara, por nëse AK këtë e konstaton atëherë, duhet te paraqes kërkesë pranë OSHP-se qe te merren masa konform nenit 99.2 te LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se me qenë se autoriteti kontraktues ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate nuk ka kërkuar dëshmi për kontratat dhe referencat e lëshuara nga sektori privat, siç do te mund te kërkonte ne pajtim me nenin 69 paragrafi 4 dhe 4.2 pika (ii) te LPP-së në te cilin nen thuhet: (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;. Kurse për këtë kërkesë OE ankues nuk ka parashtruar ankese tek AK në fazën fillestare te aktivitet te prokurimit në fjale pra pas publikimit te njoftimit për kontrate ne pajtim me nenin 108/A te LPP-së. Andaj nga te cekurat si me lart paneli shqyrtues vjen ne përfundim se autoriteti kontraktues është i obliguar që te bëj vlerësimin e ofertave ne bazë te kërkesave te vendosura ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrata sepse një obligim te tillë e përcakton edhe neni 56.3 i LPP-së, në te cilin nen thuhet se asnjë ofertues nuk mund te diskualifikohet për kërkesat te cilat nuk janë te vendosura ne dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues për shkelje te nenit 41 te RRUOPP-së, për shkelje te afateve ligjore qe kanë te bëjnë me afatin e vlerësimit te ofertave. Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues është i obliguar qe ti përmbahet afateve ligjore për procedurat lidhur me një aktivitet te prokurimit mirëpo neni 41.2 i RRUOPP thotë: Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 dite pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Andaj nga te cekurat si me lart vërtetohet se përveç 50 ditëve qe parashihen për vlerësim ne nenin e lartpërmendur, ne te njëjtin nen parashihen edhe deri ne 5 dite pasa hapjes se ofertave, fillimi i punës se komisionit te vlerësimit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues për çmimin e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, për te cilin pretendon se ka ofruar çmim Jo/ Normalisht te ulet. Paneli shqyrtues Obligon AK-ne qe te sigurohet se çmimet e ofruara janë çmime te tregut.



Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht duhet respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave nuk i është përmbajtur të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
Nuhi Paçarizi



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK –Komuna Suharekë

1x1 OE–“Flamuri 1979” – Suharekë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.